

6.6 NDRYSHIMI I STATUSIT NË MË SHUMË FUSHA NË REGJISTRIM

Të dhënat për statusin mund të ndryshoni njëkohësisht në më shumë fusha 996/997 në të njëjtin regjistrim.

Kushti

Statusi në të gjitha fushat e përzgjedhura duhet të ketë vlerën fillestare. Kjo vlerë mund të jetë 2, 4, 14 ose zbrazët.

Procedura

1. Në klasën **Materiali**, kërkoni dhe përzgjidhni materialin.
2. Përzgjidhni metodën **Objekti / Ndrysho statusin në fushat 996/997: nga 2, 4, 14 ose zbrazët në 4, 9, 14 ose zbrazët**.

Do të hapet dritarja **Lista e fushave 996/997**, ku do të përzgjidhni fushat, në të cilat dëshironi të ndryshoni statusin.

3. Klikoni butonin **Përzgjidh**.

Kur bëhet fjalë për njësinë e kompletit, të dhënat në fushën 996/997 nuk ndryshohen, përveç nëse fusha 996 ka njërin nga statutet që është përcaktuar në skedarin e konfigurimit. Në këtë rast, statusi (q) mund të fshihet ose ndryshohet në dritaren **Formimi i kompletit**. Parametri mund të vendoset në skedarin e konfigurimit në të cilin fushat 996 krijohen në mënyrë automatike në procedurën e pasurimit të materialit në modulën e programit *COBISS3/Pasurimi* (procedura është përshkruar në manualin *COBISS3/Pasurimi*, shih kap. 3.4.8.1), si dhe mundëson fshirjen dhe ndryshimin e statusit edhe në fushën 996 që e keni shtuar në mënyrë manuale. Nëse kjo procedurë nuk mund të kryhet, njësinë duhet së pari ta ndani nga kompleti.

4. Do të hapet dritarja **Ndryshimi i statusit**, ku në dritaren për futje do të futni njërin nga këto vlera të statusit ose të përzgjidhni ato nga lista e kodeve:

- 14 – të tjera
- 4 – në revizion
- 9 – çregjistruar
- rresht i zbrazët (fshirja e statusit)



Paralajmërim:

Nëse dëshironi të fshini statusin, dritaren për futje duhet ta lini të hapur.

5. Klikoni butonin **Në rregull**.

Në të gjitha fushat e përzgjedhura 996/997 do të ndryshohet vlera e statusit.